



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.03.2025
Numër Protokoll: 1890/2025

A.nr.199/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.199/2025, të datës 24.01.2025, të parashtruar nga ankuesja A.R-A, kundër organit/Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.99/2025, e datës 24.01.2025, e parashtruar nga ankuesja A.R.A.

II. Anulohet Njoftimi i datës 27.12.2024, i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shpalljen e kandidatëve fitues dhe Njoftimi i datës 12.12.2024 për verifikim paraprak, lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00015583, ndërsa procedura e pranimit kthehet në *fazën e verifikimit paraprak*.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr veprimet për vazhdimin e procedurës së pranimit nga faza e verifikimit paraprak.

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, A.R-A (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesja), me datë 23.01.2025, përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 124.01.2025, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shpalljen e rezultateve përfundimtare lidhur me konkursin me numër Reference: RN00015583, për grupin e administrimit të përgjithshëm për pozitën Zyrtar i Skemave Pensionale, i shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje MFPT), ndërsa kjo e fundit, me datë 06.02.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 520/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 15.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Konkursin e datës 23.10.2025; Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve; E-maili i datës 23.01.2025 dërguar nga ankuesja në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 06.02.2025; Vendimin me numër protokoli 3466/2024 të datës 17.12.2024 për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Konkursin me numër Reference: RN00015583, për grupin e administrimit të përgjithshëm për pozitën Zyrtar i Skemave Pensionale, i shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Njoftimin për kandidatët fitues i datës 27.12.2024; Lista e aplikantëve; Njoftimin e datës 12.12.2024 për verifikimin paraprak; Aplikacionin e kandidates B.A të datës 05.11.2024 me dokumentacionet e dorëzuara faqe 1-40; Aplikacionin e kandidates S.XH-R të datës 22.11.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-15; Aplikacionin e kandidates N.K të datës 01.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-16; Aplikacionin e kandidates D.Q të datës 19.11.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur nga faqe 1-12; Aplikacionin e ankueses i datës 19.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-7; Testin me shkrim të datës 24.12.2024 të kandidatëve fitues dhe ankueses; Formularët e datës 24.12.2024 të vlerësimit të eses për ankuesen dhe kandidatët fitues; Formularët e datës 27.12.2024 për vlerësimin e intervistës me gojë për ankuesen dhe kandidatët fitues.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se MFPT, më datë 23.10.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00015583, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm pozitë Zyrtar i Skemave Pensionale, në Departamentin e Pensioneve në Mitrovicë, katër (4) pozita, kategoria profesional 2, ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.10.2024 deri më 22.11.2024.

Tutje sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar 213 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja, dhe sipas njoftimit të datës 12.12.2024 për verifikim paraprak janë përfshirë 95 kandidat që i kanë plotësuar kushtet e konkursit në mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa pas përfundimit të fazave të vlerësimit, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MFPT-së, më datë 27.12.2024, ka publikuar njoftimin për kandidatët fitues me katër kandidatë: D. Q me 96.8 pikë, B.A me 93.8 me pikë, S.Xh-R me 93.4 pikë dhe N.K me 88.4 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, për shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se përbërja e Komisionit të Pranimi nuk ka qenë i profesionit të fushës, është bërë mbi vlerësimi i kandidatëve të suksesshëm mbi bazën e preferencave politike, sikurse komisioni ka qenë i ndikuar dhe dyshohet se ka rrjedh testi me shkrim dhe me gojë për katër (4) kandidatët fitues.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore me qëllim të sigurimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimi me Nr. reference RN00015583, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm pozitë Zyrtar i Skemave Pensionale, në Departamentin e Pensioneve në Mitrovicë të shpallur nga MFPT, ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku një vitë përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.”*

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shqyrtimit të procedurës së pranimi, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39: “1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi.” nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë

të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.

Kolegji i Këshillit, po ashtu në trajtimin e kësaj çështje administrative, mori për bazë edhe nenin 7 paragrafi 1, si dhe nenin 20 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi të Shërbimit Civil, ku përcaktohet se: “1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Komisioni i pranimi ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse”.

Fillimisht, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar aktin final të procedurës, respektivisht Njoftimin e datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, për shpalljen e kandidatëve fitues, i cili është edhe akti i kontestuar nga pala ankuese, gjegjësisht ka shqyrtuar dosjet e kandidatëve që janë shpallur si kandidatë fitues, dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve, konstaton se kandidatët D.Q, dhe N.K i kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, ndërsa kandidatja B.A si dhe S.Xh-R nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara si në konkursin e shpallur të datës 23.10.2024, për arsyet e dhëna si në vijim:

Kandidatja B.A, nga analizimi aplikacionit me dokumentacionin e bashkangjitur është konstatuar se posedon Diplomën me Nr. D-13/2015a të datës 10.08.2015 të lëshuar nga Kolegji Evropian JURIDICA, me të cilën dëshmohet se më datë 28.07.2015 ka përfunduar studimet themelore në programin Politika Publike dhe Menaxhment, ndërsa lidhur me përvojën e punës pas diplomimit në bazë të Referencës së datës 05.05.2021 të lëshuar nga Qendra për Edukim të Fëmijëve, e njëjta nga data 04.09.2019 deri në lëshimin e referencës(datë 05.05.2021) ka qenë duke punuar si Edukatore, sipas vërtetimit të datës 03.01.2022, konfirmohet se ka kryerë punë praktike me pagesë nga data 01.10.2021 deri më datë 31.12.2021 në kompaninë International Financa&Services SH.P.K, sipas Vërtetimit të datës 28.02.2024 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut e njëjta nga data 10.07.2023 deri më datë 10.01.2024 ka kryer praktikën profesionale në këtë qendër, sipas Kontratës së datës 11.04.2024 të lidhur mes kësaj kandidateje dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës e njëjta nga data 29.03.2024 deri më datë 25.05.2024, ka qenë e angazhuar si Regjistruese në kuadër të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas këtyre dëshmive rezulton se kjo kandidate në institucione publike ka praktikë gjashtë mujore në Qendrën për Punë Sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe dy (2) muaj përvojë pune në kuadër të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ndërsa në institucionet private ka përvojë punë sikurse ajo në Qendrën për Edukim të Fëmijëve dhe kompaninë International Financa&Services SH.P.K për periudhat të specifikuara si më lartë.

Po ashtu edhe kandidatja S.Xh-R, nga analizimi aplikacionit me dokumentacionin e bashkangjitur është konstatuar se posedon Diplomën me Nr. 024/14 të datës 30.07.2014 të lëshuar nga Kolegji Globus me të cilën dëshmohet se më datë 09.07.2014 ka mbaruar studimet themelore në Financa dhe Kontabilitet Ndërkombëtar, ndërsa lidhur me përvojën e punës, e njëjta posedon letër Referencën e datës 14.02.2024 e lëshuar nga sh.p.k Llogaritari ku përshkruhet se ka kryer praktikën mirëpo nuk përcaktohet periudha kohore, ndërsa sipas certifikatës së kontributit pensional së datës 20.11.2024 të lëshuar nga punëdhënësi të njëjtës i figuron periudha tatimore nga muaji 10/2023 deri më 09/2024 në kompaninë Delta Finance Group LLC. dhe nuk ka dëshmi tjetër të përvojës së punës, mirëpo certifikata në fjalë nuk përmbush kërkesën e konkursit, ngase është lëshuar nga vetë punëdhënësi, pra nuk është dokument i lëshuar nga ATK-ja.

Bazuar nga dëshmitë e përvojës së punës së këtyre dy kandidateve, rezulton se asnjëra nga kandidatët përvojën e punës në institucionet private nuk e kanë dëshmuar me pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore siç është kërkuar me pikën e pestë (5) të konkursit ku është kërkuar: *Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet në paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale, në këtë rast Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e MFPT-së, me rastin e përfshirjes së kësaj kandidateje në listën e verifikimit paraprak dhe listën e kandidatëve fitues ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, nenin 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi ankimor i ankueses ndaj këtij njoftimi është i bazuar.*

Duke marr parasysh faktin se ankesa në procedurë të pranimi parashtrohet vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, atëherë Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar edhe përbërjen e Komisionit të Pranimit dhe nga analizimi i Vendimit me numër protokollit 3466/2024 të datës 17.12.2024 të nxjerr nga u.d Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së, është themeluar Komisioni i Pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve në procedurën e pranimi për pozitën Zyrtar i Skemave Pensionale, në përbërje: 1.B.H-Kryesues, me P.P-zëvendësues, 2. J.B-anëtar, me O.D-zëvendësues; 3. V.L-anëtare, me H.Rr-R-zëvendësuese; 4. A.B-anëtar, me A.K-zëvendësues, dhe 5. L.H-anëtare, me A.H-zëvendësuese, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar edhe provat tjera, për të konstatuar se kush ka qenë anëtar të Komisionit të Pranimit në vlerësimin e kandidateve dhe nga formularët e vlerësimit të eses dhe formularët e intervistës me gojë rezulton se anëtar të Komisionit të Pranimit që kanë vlerësuar kandidatët kanë qenë: B.H, J.B, H.Rr-R, A.B dhe L.H, e për rrjedhojë nga provat e lëndës, gjegjësisht akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit, rezulton se B.H mban pozitën Drejtor i Departamentit të Pensioneve, J.B mban pozitën Zyrtar i Lartë për Programin e Trajnimeve, H.Rr-R mban pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Aplikacioneve, A.K, mban pozitën Zyrtar i lartë për Monitorim të Kontratave në PPP dhe L.H mban pozitën Zyrtare e Personelit. Atëherë, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, ka ardhur në përfundimin se përbërja e Komisionit të Pranimit është në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuar me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për

Zyrtarët Publikë dhe nenit 20 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet: “1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse”, sepse, Komisioni i Pranimi në këtë rast është themeluar me vetëm dy (2) anëtarë në pozitë të nivelit të ulët/mesëm drejtues, ndërsa sipas kërkesave ligjore **tre (3)** nga anëtarët duhet të jenë nëpunës/ës civil të **nivelit të mesëm apo të ulët drejtues** të specializuar në fushën përkatëse.

Prandaj, thënë si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, meqenëse dy (2) nga kandidatët fitues nuk i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale atë të përvojës së punës dhe se Komisioni i Pranimi për vlerësimin e kandidateve në procedurën e rekrutimit më numër reference RN00015583, nuk është emëruar në pajtim me ligjin material, atëherë në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, çdo veprim administrativ i ndërmarr nga faza e verifikimit paraprak konsiderohet juridikisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si pasojë, Kolegji i Këshillit mbi bazën e këtyre të gjeturave vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj Njoftimin e datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues për procedurën e pranimi më numër të referencës RN00015583, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e verifikimit paraprak, duke obliguar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MFPT-së, që në afat kohor sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit, të ndërmarr të gjitha veprimet për vazhdimin e procedurës së pranimi nga faza e verifikimit paraprak, kështu që bazuar në atë që u theksua si më lartë Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera ankimore.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.199/2025, datë 21/03/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.R-A;
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.